



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

KOMUNA E KLINËS

KUVENDI I KOKUNËS

01. NR. 07 - 5539/15

KLINË, 19.10.2015

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

#### NGA DEBATI ME PUBLIKUN, I MBAJTUR MË 19.10.2015, NË ORËN 10.00, NË SALLËN E KUVENDIT TË KOMUNËS

Ne debat prezantuan: Kryesuesi i Kuvendit, Dr. Haxhi Ibishi, drejtore të drejtorive komunale, Zyra ligjore, përfaqësuesit të bashkësive fetare, OSBE, OJQ "Koha" dhe qytetarë.

Debatin e udhëhoqi kryesuesi i KK, Dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe ju dëshiroi mirëseardhje në këtë debat.

Kryesuesi prezantoi këtë

#### REND DITE

1. Projekt-ndryshimet dhe plotësimet e Planit Zhvillimor Komuna 2014-2021, për ridestinimin e dy parcelave: Në Këpuz – pronë shoqërore e KK Klinë, me kulturë kullosë, pjesë e parcelës 279-0, në sipërfaqe prej 0.10.00, që të ridestinohet për tokë ndërtimore. Në ZK Deiq – pronë shoqërore me kulturë rrugë, pjesë e parcelës kadastrale, Nr. 1000-0, në sipërfaqe prej 2115 katrorë (0.21.15), që të ridestinohet në tokë ndërtimore.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi pjesëmarrësit që Planin Zhvillimor Komunal e kemi aprovuar në seancën e kaluar të KK. Kuvendi ka marrë vendim për dy parcela, në Këpuz për ndërtimin e xhamisë dhe në Deiq për ndërtimin e kishës. Anëtarët e Kuvendit kanë qenë unanimisht në dhënien e këtij vendimi. Ministria e Planifikimit Hapësinor e ka kthyer në rishqyrtim këtë vendim të Kuvendit, tash kemi hyrë në procedurat e legalizimit, prandaj jemi në hapa ligjorë. Sot lëshohet në diskutim publik", shtoi kryesuesi Ibishi, i cili në vazhdim lexoi vendimin e seancës paraprake të KK për lëshim në diskutim publik të Ndryshimeve dhe Plotësimeve të Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021.

Kryesuesi Ibishi në vazhdim fjalën ia dha drejtorit të Gjeodezisë dhe Kadastrit, z. Zeqir Morina.

**Zeqir Morina (drejtor i Drejtorisë së Kadastrit dhe Gjeodezisë)**, në mënyrë kronologjike sqaroi çështjen ën shqyrtim. “Gjeodezia ka kryer punët dhe përgjegjësitë e veta. Sa i përket gjeodezisë çdo gjë është në rregull”, shtoi ndër të tjera drejtori Morina.

**Tunë Dedaj (Deiq)**, theksoi se 27 këshilltarë rë Kuvendit të Komunës kanë dhënë lejen. “Është bërë punë e madhe. Ka qenë një gjë shumë e keqe nga ana e ministrisë për ndalimin e punëve. Falënderoj Kryetarin dhe Kryesuesin për kontributin që kanë dhënë në këtë drejtim. Dhashtë Zoti që shpejt të realizohen këto projekte!”-shtoi Dedaj. Haxhi Ibishi, tha se ne do t’i udhëheqim procedurat ligjore. “Vendimmarrja ka qenë unanime”, sqaroi Kryesuesi.

**Fadi Destani (Zajm)**, tha se lidhur me vendimin kisha ngritur 2-3 çështje: “Çështja e parë, kur janë votuar kërkesat, kam konsideruar që ai vendim është marrë me nguti. Këshilltarët nuk paskan ditur se çka votojnë. Prandaj, faji është i këshilltarëve. Pra, përgjegjësinë i mbajnë Kuvendi dhe KPF-ja. Çështja tjetër, u tha një thonjëza “është bërë punë e mirë”. Ministria ka mbrojtur ligjshmërinë. Për çështje të caktuara bëhen rregullore. Ta bëjmë një rregullore për ndarjen e pronave publike. Para se të merren vendime të analizohen gjерat, në marrëveshje me ministritë përkatëse, pastaj të merren vendime”, nën vizoi z. Destani.

**Haxhi Ibishi**, sqaroi çështjen e rregulloreve dhe u pajtua që të jenë më azhur.

**Refki Krasniqi**, tha se desha të them diçka për sqarim:”Strukturat e Komunës si dhe organet e Kuvendit Komunal, përfshirë të gjithë këshilltarët e Kuvendit, nga vullneti i madh që këtyre bashkësive fetare t’ju përgjigjet pozitivisht në kërkesat e tyre, ka marrë vendim që t’ju ndajë tokë. Kjo që ne sot jemi duke debatuar, është një dëshmi më shumë që Komuna dhe Kuvendi janë shume transparente në punën e tyre. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka kërkuar nga Kuvendi që të rishikoj edhe një herë vendim, në mënyrë që të përfillej të gjitha procedurat ligjore, dhe që kjo pune të kryhet sipas ligjeve të Kosovës”, ka nën vizuar Krasniqi.

**Haxhi Ibishi**, pohoi se rastin ka qenë tepër specifik. Dr. Ibishi sqaroi edhe shumë gjera të tjera në debatim. “Nuk është bërë shkelje e qëllimshme”.

**Muhamet Foniqi (Zajm)**, kërkoi që të rregullohet çështja e shtratit të lumbit Drini i Bardhë, në mënyrë që banorët e fshatit Zajm të mos janë të rrezikuar nga vërshimet, siç ka ndodhur rasti i vitit 2013. Zoti Foniqi, kërkoi formimin e një komisioni për vlerësimin e gjendjes.

**Fitim Bojaj (imam i Xhamisë në Klinë)**, tha se kërkesat janë bërë që 6 muaj. “Falënderoj të gjithë ata që kanë qenë me ne. Kemi bërë kërkesën për ndërtimin e

xhamisë në fshatin Këpuz. Kemi konsideruar se ndërtimi i xhamisë në atë lokalitet është më se i domosdoshëm, ngase besimtarët e për t'i kryer ritet fetare janë të obliguar që të udhëtojnë me nga 20 kilometra për të mbërrit në xhanin e Klinës, të Baranit etj. Ne akoma nuk kemi marrë përgjigje deri ku kanë shkuar dhe ku kanë mbetur çështjet”, shtoi imami Bojaj.

**Lenc Sopi (famullitar i Kishës së Klinës)**, tha se falënderoj Kuvendin e Komunës për gatishmërinë e tyre përkrahjen që na kanë dhënë në kërkesën tonë. “Kemi dëshiruar që të ndiqen procedurat, në mënyrë që më vonë të mos ketë vrima për diskutime të mëtutjeshme. Ndjejmë kënaqësinë që kemi hasur në mirëkuptim”, shtoi ndër të tjera famullitari Sopi.

**Elbasan Raci (OJQ “Koha”)**, fillmisht foli rreth rolit të tyre në çështjen e monitorimit në Komunën e Klinës. Duke folur rreth çështjes në shqyrtimi z. Raci theksoi një nga problemet ka qenë mos respektimi i procedurave ligjore. “Kërkojmë nga Komuna që të marr në konsideratë vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet e qytetarëve që ata i shprehin në debatet me qytetarë. Kemi probleme të procedurave ligjore, po ashtu edhe nga ministritë”, shtoi ndër të tjera, z. Raci.

**Baki Gashi (drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm)**, foli rreth çështjes në rend të ditës. “Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal ka ndodhur pas kërkesave të bashkësive fetare. Plani Zhvillimor Komunal rreth këtyre dy ngastrave kërkon kohë. Ministritë kanë kërkuar respektimin e procedurave”, pohoi drejtori Gashi, i cili në vijim foli rreth dy ngastrave në shqyrtim. “Fillojmë me respektimin e procedurave. Ndryshimi i Planit Zhvillimor Komunal kërkon kohë. Qëllimi i debatit të sotëm është, a jeni ju si qytetarë për ndryshimin e statusit të këtyre dy ngastrave”, pohoi drejtori Gashi.

**Ali Shala**, në mënyrë kronologjike sqaroi lidhur me dy ngastrat.”Si Komunë kemi nisur procedurat për ndryshimin e destinimit të këtyre dy ngastrave. Kemi pasur mendim pozitiv. Kohëve të fundit nga Kuvendi i Kosovës është miratuar Ligji i dhënies së pronave komunale, që ka diktuar edhe lidhur me rastin tonë konkret”, pohoi zyrtari i lartë ligjor, z. Shala, i cili në vijim foli rreth Ligjit për dhënien e pronave komunale të miratuar nga Kuvendi i Kosovës. “Qëllimi ynë është krejt në aspektin e respektimit të procedurave ligjore. Me këtë rast, kemi të bëjmë me ndërrimin e destinimit të ngastrave konkrete. Respektimi i procedurave merr kohë. Jemi duke bërë përpjekje të bëjmë korrigjime dhe respektimin e të drejtave ligjore. Duhet të na mirëkuptojnë edhe përfaqësuesit të bashkësive fetare. Sot kemi për qëllim për të marrë një konfirmim për të hyrë në rrjedhat normale tub procedurave. Dëshirojmë për t'i respektuar rrjedhat e procedurave ligjore. Jemi në rrugën e përfilljes meritore në miratimin e këtyre dy vendimeve”, sqaroi ndër të tjera zyrtari i lartë Shala.

**Fadil Desatni**, foli rreth çështjes në debatim. “Përgjegjësinë e ka komisioni komunal. Çka po që se vjen edhe një komunitet tjetër fetar? Kërkesat e qytetarëve nuk po përfillen. Prej 150 kërkesa është dashur që 147 të inkorporohen, ndërsa vetëm 3 për të mbetur”, shtoi z. Destani.

Kryesuesi Ibishi, falënderoi pjesëmarrësit për kontributin e tyre të dhënë në këtë debat me publikun.

Debatin e konsideroi të përfunduar.

Debati i mbyll në orën 10.00.

Procesmbajtësi,  
Mikel GOJANI



Kryesuesi i seancës,  
Dr. Haxhi IBISHI

